



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1893/B Prot.

Vlorë më, 17.07 2025

VENDIM

Nr. 72, datë 17.07.2025

PËR

MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE NË PROGRAMIN E STUDIMIT PROFESIONAL 2 (DY) VJEÇAR "SPECIALIST NË SHËRBIME DHE OPERACIONE DETARE DHE BREGDETARE " PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026

Në mbështetje të nenit 38, 72, të ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, gërma g, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, referuar shkresës 1887/1, prot, datë 17.07.2025, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 17.07.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret e pranimit të studentëve në programin e studimit profesional 2(dy) vjeçar "Specialist në shërbime dhe operacione detare dhe bregdetare" sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Kriteret e miratuara i përcillen MAS dhe QSHA.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.DR. Aurela Saliaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
DREJTOR I SHËRBIMEVE NDIHMËS AKADEMIKE**

Nr. 867 / Prot.

Vlorë më, 17.07.2025

Lënda: Relacion për kriteret e pranimit të studentëve në programet e reja studimit në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë për Vitin Akademik 2025-2026.

**PROF.DR.AURELA SALIAJ
KRYETARIT TË SENATIT AKADEMIK**

KËTU

Referuar shkresë së MAS, Drejtorisë së Programeve të Arsimit të Lartë me nr. 7955/1 prot datë 19.12.2024, për "Publikimin e kriterëve të pranimit të studentëve për vitin akademik 2025-2026 dhe 2026-2027" si dhe bazuar në shkresën nr.372 prot, datë 16.07.2025 të Fakultetit të Shëndetit, shkresën nr.372/2 prot, datë 16.07.2025 të Fakultetit të Ekonomisë, shkresat me nr.380/1 prot, datë 17.07.2025, nr.381/1 prot, datë 17.07.2025, nr.376/1 prot, datë 16.07.2025 dhe nr.359/4 prot, datë 16.07.2025 të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore Ju dërgoj relacionin mbi Kriteret e pranimit të studentëve në programet e reja të studimit në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë për Vitin Akademik 2025-2026:

FAKULTETI I EKONOMISË

Program Profesional 2 (dy) vjecar "Operator Turistik"

1. Në programin profesionale të studimit Diplome Profesionale dy vjecare "Operator Turistik", për vitin akademik 2025-2026, në Fakultetin e Ekonomisë do të pranohen kandidatë, të cilët kanë mbaruar studimet e shkollës së mesme. Kandidatët do të perjashtohen nga kriterii notes mesatare.

Master i Shkencave në "Marketing Dixhital"

1. Në programin e studimit Master i Shkencave në "Marketing Dixhital", në Fakultetin e Ekonomisë do të pranohen kandidatë, të cilët zotërojnë të paktën një diplomë "Bachelor" në Ekonomi, apo dhe fusha të tjera studimi. Kandidatët do të përzgjidhen mbi bazën e notes mesatare dhe diplomës që zotërojnë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
DREJTOR I SHËRBIMEVE NDIHMËS AKADEMIKE**

FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE

Bachelor në "Computer Engineering"

1. Përzgjedhja bazohet në renditjen e studentëve sipas pikëve të grumbulluara, nga më e larta në më të ulëtën, të llogaritura në bazë të notës mesatare të shkollës së mesme dhe rezultateve të provimeve të Maturës Shtetërore.
2. Në rast se kandidatët kanë të njëjtin total pikësh, kriter përzgjedhës do të jenë rezultatet në provimet me zgjedhje (Matematikë, Fizikë).
3. Të keni certifikatën e njohjes së gjuhës angleze (niveli B1 ose më i lartë);

Bachelor në Matematikë - Informatikë

1. Kriteret e parashikuara nga ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 74 pika 1 "*Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave*".
2. Kriteret e pranimit në ciklin e parë të studimeve për vitin akademik përllogariten 50% nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore dhe 50% grupë lëndëve bërthamë (për të gjithë vitet ku shtrihen lëndët)
3. Në grup lëndët përfshihen lëndët e mëposhtme me peshat specifike si mëposhtë:
 - Matematikë 25%
 - TIK 25%

Program Profesional 2(dy) Vjecar "Programim Ëeb Dhe Dizenjim Digjital"

1. Përzgjedhja kryhet duke i renditur studentët në bazë të pikëve totale, nga pikët më të larta në pikët më të ulëta, të llogaritura mbi bazën e notës mesatare të studimeve të shkollës së mesme dhe të rezultateve të Maturës Shtetërore.
2. Në rast se kandidatët kanë pikë totale të njëjta, si kriter përzgjedhjeje do të shërbejnë pikët e provimeve me zgjedhje



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
DREJTOR I SHËRBIMEVE NDIHMËS AKADEMIKE**

Program Profesional 2(dy) vjecar "Specialist në Shërbime dhe Operacione Detare dhe Bregdetare"

1. Përzgjedhja kryhet duke i renditur studentët në bazë të pikëve totale, nga pikët më të larta në pikët më të ulëta, të llogaritura mbi bazën e notës mesatare të studimeve të shkollës së mesme dhe të rezultateve të Maturës Shtetërore.
2. Në rast se kandidatët kanë të njëjtin total pikësh, përparësi do të kenë kandidatët që kanë mesatare më të latë në lëndën informatikë dhe gjuhë të huaj në tre vitet e studimit në shkolën e mesme.

Master i Shkencave në "Inxhinieri Armatimi me profil minor në Aviacion dhe navale"

1. Të kenë përfunduar me sukses një program studimi të ciklit të parë (bachelor) në fushat e inxhinierisë mekanike, elektrike, elektronike, kimi industriale, Akademisë së Forcave të Armatosura, Foecës Ajrore, Inxhinierisë Navale , ose fusha të tjera të afërta teknike të njohura nga institucioni.
2. Gjuha e huaj sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë.

Kritere të tjera

1. Të kenë një mesatare të përgjithshme të studimeve paraardhëse të paktën mbi pragu e vendosur nga universiteti.
2. Përvojë të dokumentuar profesionale në sektorin e mbrojtjes ose industrisë inxhinierike.
3. Kritere të tjera , të përcaktuara nga marrëveshja ndër-institucionale me Akademinë e Forcave të Armatosura ose me vendim të dy senatave Akademike
4. Eksperiencë pune në fushën përkatëse brenda ose jashtë vendit.

FAKULTETI I SHËNDETIT

Asistencë në Geriatri

1. Kriteri përzgjedhës me 100% të pikëve do të jetë mesatarja e përgjithshme e shkollës së mesme, pa nivel minimal sipas përcaktimeve nga Ministria e Arsimit dhe Sportit e llogaritur nga QSHA sipas rendit zbritës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
DREJTOR I SHËRBIMEVE NDIHMËS AKADEMIKE

2. Kandidatët do të renditen në rend zbritës sipas mesatares së shkollës së mesme të përlogaritur nga QSHA.
3. Në rast se do të ketë kandidatë me pikë të barabarta, renditja do të bëhet në rend zbritës sipas mesatares së 3 (tre) viteve të lëndës së Biologjisë. 6. Në rast se sërish do të ketë kandidatë me pikë të barabarta, renditja do të bëhet në rend zbritës sipas mesatares së 3 (tre) viteve të lëndës së Kimisë.

DREJTOR

Belinda Dauti